




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-02/DPK Nr. Prot. 01-1115/16  
 Dep. 03-02/DPK Br. Prot. 01-1115/16  
 Nr. i faq. 02 Data 15.03.2016  
 Broj stranica 02 Datum 15.03.2016  
 Nr. pages 02 Date 15.03.2016



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.03.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3907/15, për z. Qerim Selimi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Qerim Selimi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas pranimit të informacionit për dyshimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit sipas të cilit zyrtari i lartë z. Qerim Selimi - Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, është duke ushtruar edhe funksionet Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Mitrovicës "Isa Boletini", si dhe Anëtar i Këshillit Qendror Shtetëror të Maturës.

Zyrtari i lartë z. Selimi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së

cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit për gjendje të mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë ka deklaruar se krahas ushtrimit të funksionit – Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri ushtron edhe funksionin e Anëtarit të Këshillit Qendror Shtetëror të Maturës, ndërsa funksionin e Anëtarit të Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Mitrovicës “Isa Boletini”, nuk e ushtron që nga data 11.06.2015.

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare nga Rektori i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, me të cilën vërtetohet se z. Selimi nuk është Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit Publik të Mitrovicës “Isa Boletini”, këtë funksion publik e ka ushtruar nga data 25.06.2013 deri me datën 11.06.2015.

Zyrtari i lartë z. Selimi në funksionin Anëtar i Këshillit Qendror Shtetëror të Maturës është emëruar nga Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi (3.2), të Ligjit nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore në të cilin thuhet se tre anëtar në këtë Këshillë duhet të jenë nga Universiteti.

Ushtrimi i funksionit Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri dhe njëkohësisht Anëtar i Këshillit Qendror Shtetëror të Maturës nuk paraqet konflikt interesi. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të interesit nr.04/L-051, nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim.

Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera neni 10 (paragrafi 2) të Ligjit për PKI.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

